



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:266853

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05541918

PROCESVERBAL

I përpiluar më 04.04.2024, në GJYKATA KOMERCIALE

Gjyqtari,

Alajdin Tërshnjaku

Paditësi:

1.The Polo / Lauren Company L.P., mes seli në 650, Madison Avenue, Neë York, 10022, me Nr. te regjistrimit 26-0208359, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria E Avokatëve “Vokshi &Lata”, me avokat Florin Lata me seli te zyrës në Prishtinë.

Z.Ligjore

Vesa Statovci

I Paditur:

1.DMR Accessories Sh.p.k, me NUI 811855115 me seli në Prishtinë, Rr. Agim Ramdani, nr.191, e ët cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati Artan Bunjaku, me seli të zyrës në Prishtinë

Lënda kontestuese: Shkelje e Markës Tregtare

Filloi në ora 13:40

Shqyrtimi është publik

Gjyqtari e hapë shqyrtimin e çështjes, kumton lëndën e shqyrtimit dhe konstaton se në shqyrtim kanë ardhur:

Për Paditësin: sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Vokshi &Lata”, me avokat Florin Lata me seli te zyrës në Prishtinë.

Për të paditurin: sipas autorizimit e përfaqëson avokati Artan Bunjaku, me seli të zyrës në Prishtinë.

I autorizuari i palës paditëse deklaron: Në seancën e sotme kemi shprehur vullnetin që me të autorizuarin e të paditurit të arrijmë pajtim gjyqësor, pasi në shkresat e lëndës u gjet deklarata për lëshim dhe shkatërrim e palës së paditur metë cilën kishte dhënë pëlqimin për asgjësimin e mallit kontestues.

I propozoj gjykatës që ta aprovojë këtë :

Pajtim

-Lejohet shkatërrimi i mallit 407 orë dorë, që shkelin Markën Tregtare me Nr.017145 dhe 001424 dhe obligohet i padituri që nën mbikëqyrjen doganore me shpenzimet e tij të bëjë shkatërrimin e mallit brenda afatit prej 30 ditësh;

-Obligohet i padituri që paditësit t'i paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 185 euro, 50 euro në emër të taksës gjyqësore dhe 135 në emër të një seance gjyqësore e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh .

E autorizuar e palës së paditur deklaron: Pajtohem me propozimin për arritjen e ujdisë ashtu si e paraqiti përfaqësuesi i paditësit.

Pasi që palët ndërgjyqëse kanë vullnet që të lidhin pajtim gjyqësor lidhur me këtë çështje që është objekt kontesti, gjykata konstaton se në mes të palëve ndërgjyqëse është arritur:

PAJTIMI GJYQËSOR

- I- Lejohet shkatërrimi i mallit 407 orë dorë, që shkelin Markën Tregtare me Nr.017145 dhe 001424 dhe obligohet i padituri që nën mbikëqyrjen doganore me shpenzimet e tij të bëjë shkatërrimin e mallit brenda afatit prej 30 ditësh;
- II- Obligohet i padituri që paditësit t'i paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore, 50 euro në emër të taksës gjyqësore dhe 135 në emër të një seance gjyqësore shumë totale në lartësi prej 185 euro e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh

Gjykata pasi analizoi objektin e këtij pajtimi gjyqësor në kuptim të nenit 3 të LPK-së konstatoi se kemi të bëjmë me kërkesë që palët mundë të disponojnë lirisht.

Andaj në bazë të nenit 414 par.1 dhe nenit 416 të LPK-së gjykata merr këtë:

AKTVENDIM

I-lejohet lidhja e këtij pajtimi gjyqësor në këtë çështje juridike kontestuese ashtu siç u konstatua më lart;

II- ky pajtim gjyqësor ka fuqinë e aktit përmbarues;

III- lënda çregjistrohet nga regjistri civil dhe arkivohet sie kryer.

Gjykata merr :

AKTVENDIM

Konstatohet se kjo çështje juridike kontestimore përfundoi.

Seanca e sotme përfundoi ne orën 14:05

Palët prezentë procesverbalin e lexuan dhe e nënshkruan pa vërejtje.

I autorizuari i palës paditëse:

Av.Florin Lata

I autorizuari i palës së paditur:

Av.Artan Bunjaku

V e r t e t o j n ë

Z.Ligjore,

Gjyqtari,